



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202003231/5

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave të menjëherëshme, për:*

*(i) zgjerimin e paketës së barnave për trajtimin ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me COVID-19, duke përfshirë në të analizat laboratorike dhe ekzaminimet imazherike për diagnostikim dhe monitorim të ecurisë klinike të pacientit;*

*(ii) Garantimin e ofrimit pa asnjë diskriminim të shërbimit shëndetësor, duke përfshirë si kategori përfituese edhe individët të diagnostikuar me Covid -19, për periudhën Mars-Nëntor 2020.*

*(iii) Garantimin e ofrimit pa asnjë diskriminim të shërbimit shëndetësor – pakete barnash, duke mos e kufizuar atë vetëm për pacientët e konfirmuar pozitiv me tampon nga institucionet shëndetësore publike por duke e ofruar atë për të tërë pacientët e diagnostikuar me këtë sëmundje infektive pavarësisht mënyrës së kryerjes së ekzaminimit apo institucionit shëndetësor kur është kryer ai.*

**Drejtuar:** **Zj.Ogerta MANASTIRLIU**

*Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*

**TIRANË**

*E nderuar zonja Ministre,*

Institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar në vijimësi me shumë vëmendje masat e marra nga autoritetet shqiptare për përballimin me sukses të pandemisë së Covid 19.

Me një qasje e cila ka në fokus të saj respektimin e të drejtave të njeriut dhe pacientit, e përcaktuar specifikisht në aktet ndërkombëtare dhe të brendshme, institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2020 ka adresuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale disa problematika të qënësishme të bëra publike në media nga profesionistë të sistemit shëndetësor, intelektualë e akademikë me qëllim mundësimin e ushtrimit efektiv të së drejtës së qytetarëve për kujdes shëndetësor dhe akses të barabartë në këto shërbime.

Me të njëjtën qasje, sipas së cilës parimi mbi të cilin duhet të mbështet funksionimi i sistemit shëndetësor është tërësia e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, cilësia e këtyre shërbimeve dhe eficienta, duke garantuar sigurinë e pacientit, pa kosto shtesë, institucioni i Avokatit të Popullit ka nisur me inisiativë çështjen e identifikimit të kategorive përfituese dhe impaktin financiar (në drejtim të lehtësimit të barrës financiare) që gjeneroi tek qytetarët e infektuar me Covid-19, miratimi i Vendimi të Këshillit të Ministrave nr.908, datë 18.11.2020 “Për miratimin e Paketës së Barnave për Trajtimin ambulator në banesë të Personave të Diagnostikuar me COVID-19”.

Sjellim në vëmendje se, mbrojtja e shëndetit dhe e drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë e mbrojtur jo vetëm nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore në RSH, por edhe nga një sërë aktesh ndërkombëtare në të cilat vendi ynë ka aderuar, të tilla si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Karta Sociale Evropiane, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, etj.

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë neni 55 parashikon se :

- *Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti;*
- *Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.*

Ligji Nr. 15/2016 “Për Parandalimin dhe luftimin edhe sëmundjeve infektive”, Neni 4; përcakton parimet për parandalimin dhe luftimin (trajtimin) e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive si më poshtë:

- (i) *parandalimi i sëmundjeve ngjitëse në territorin e Republikës së Shqipërisë është i detyrueshëm;*
- (ii) ***parandalimi dhe luftimi i infeksioneve dhe sëmundjeve infektive ofrohet pa asnjë lloj diskriminimi;***
- (iii) *mbrojtja nga sëmundjet infektive bëhet sipas një planifikimi, programimi, organizimi, zbatimi të masave për parandalimin, diagnozën, trajtimin, luftimin, zhdukjen e sëmundjeve infektive dhe sigurimin e mjeteve e infrastrukturës së domosdoshme për mbrojtjen shëndetësore ndaj tyre;*
- (iv) ***çdo person ka të drejtë të përfitojë nga masat për mbrojtjen nga sëmundjet infektive;***
- (v) ***çdo person i sëmurë nga sëmundjet infektive me karakter epidemik ka të drejtën dhe detyrimin të mjekohet falas në çdo institucion shëndetësor publik apo jopublik;***

Gjithashtu, në ligjin nr.10138, dt.11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, në nenin 28, parashikohet se: “Parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve infektive përfshin mbikëqyrjen epidemiologjike të këtyre sëmundjeve e të faktorëve të rrezikut, si dhe tërësinë e masave, që synojnë parandalimin e zhvillimit të agjentëve infektivë, minimizimin e shfaqjes ndaj infeksioneve, reduktimin e ndjeshmërisë së individëve dhe të popullatës ndaj sëmundjeve infektive, parandalimin e zhvillimit të shenjave biologjike e klinike të këtyre sëmundjeve, **diagnozën e hershme dhe trajtimin e bazuar në evidencë të sëmundjeve infektive** dhe parandalimin apo minimizimin e ndërlikimeve nga këto sëmundje”.

Nisur nga sa më lart, për të përmbushur detyrimet që gjenerojnë nga kuadri ligjor ekzistues për përballimin e situatave epidemike dhe më konkretisht detyrimet e përcaktuara shprehimisht në Ligjin Nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, qeveria miratoi Vendimin e Këshillit të Ministrave (“VKM”) Nr.908, dt.18.11.2020, “Për miratimin e paketës së trajtimit COVID-19 ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me COVID-19”.

VKM-ja e sipërcituar u implementua jo pa sfida, duke evidentuar qysh në fazë të hershme, problematika të qarta dhe me impakt negativ për qytetarët, veçanërisht në raport me :

- (i) *kategori të individëve të diagnostikuar me Covid -19, përfitues të paketës së barnave për të cilat ofrohet rimbursim në kushtet e trajtimit ambulator në banesë;*
- (ii) *skemën (protokollet) e trajtimit me barna të individëve të infektuar me Covid -19, duke mos përfshirë në të, analizat laboratorike dhe ekzamimet imazherike për diagnostikim dhe monitorim të ecurisë klinike të pacientit.*

VKM-ja nr. 908, dt.18.11.2020 “Për miratimin e paketës së trajtimit COVID-19 ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me COVID-19”, përcakton rimbursimin e dy paketave për trajtimin ambulator në shtëpi, sipas stadeve. Për formën e lehtë (Stadi I) u vendos rimbursim deri në vlerën 1,650 lekë, ndërsa për formën e mesme (Stadi II) rimbursim deri në 10,900 lekë.

Më tej, në udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë, miratuar përmes Urdhrit Nr. 579, dt.14.10.2020 “Për Miratimin e udhëzuesit mbi ndjekjen në shtëpi të rasteve me infeksion Covid-19”, detajohet procedura e mjekimit të pacientëve në shtëpi nga mjeku i familjes, për stadin I dhe II, njeherë **që pacientët diagnostikohen me tampon si pozitiv nga institucionet shëndetësore publike**. Ky udhëzim përcakton shprehimisht edhe skemën/ protokollin e trajtimit të tyre me barna.

Më konkretisht, ky udhëzues përcakton për stadin I dhe II, trajtimin si më poshtë: *Stadi I*. Vitamino terapi (Vit. C), 2. Lëngje, 3. Antipiretikë kur ka temperature, 4. Trisol kur ka diarre, 5.Shurup për kollë kur ka kollë. Për të sëmurët kronikë mund të fillohet edhe antibiotik (azitromicinë ose levofloxacin) si edhe antikoagulantë.

*Stadi II*: 1.Antibiotikë, 2. Kortizonikë, 3. Antikoagulantë, 4.Vitaminoterapi, 5. Antipiretikë, 6. Shurup për kollë. Ky udhëzues, për stadin II përfshin edhe kryerjen e ekzaminimit imazherik (CT Skaner), në ditën e pestë.

Në analizë të parashikimeve të VKM nr.908, dt.18.11.2020 dhe të Urdhrit Nr. 579, dt.14.10.2020, me referencë kategori të qytetarëve të cilët klasifikohen si përfitues të paketës së barnave, për të cilat ofrohet rimbursim në kushtet e trajtimit ambulator në banesë, vërejmë se për t`u kualifikuar si kategori përfituese, qytetarët duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative, dy kushte:

- (i) të diagnostikohen si të infektuar me Covid -19, pas hyrjes në fuqi të VKM nr.908, dt.18.11.2020;
- (ii) të konfirmohen si pozitivë me tampon nga institucionet shëndetësore publike;

Sic mund të konstatohet lehtësisht, në dritën e parashikimeve të përfshira në aktet ligjore të sipërcituara, nuk kualifikohen si kategori përfituese të një recete me rimbursim të dhënë nga mjeku i familjes për statin (I) dhe (II) **pacientët të diagnostikuar me Covid-19 për periudhën Mars-Nëntor 2020, përpara hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 908, dt.18.11.2020, si dhe pacientët, pas hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je, por që janë konfirmuar pozitivë me tampon nga institucionet shëndetësore private ( jo publike).**

VKM-ja ka kufizuar ndjeshëm, në disfavor të qytetarëve, kategoritë përfituese të një recete me rimbursim, të dhënë nga mjeku i familjes për statin I dhe II, duke mos marrë në konsideratë individët e diagnostikuar me Covid-19, për periudhën Mars-Nëntor 2020, përpara hyrjes në fuqi të VKM nr. 908, dt.18.11.2020 të cilët kanë marrë trajtimin mjeksor përgjatë kësaj periudhe duke e përballuar atë tërësisht nga të ardhurat e tyre.

Njësoj problematikë identifikohet të jetë situata financiare më të cilën po ballafaqohen individët e diagnostikuar me Covid-19, pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 908, por të konfirmuar si pozitiv me tampon nga ***institucionet shëndetësore private***.

Kjo kategori rezulton të jetë përjashtuar si përfituese e paketës së barnave për të cilat ofrohet rimbursim në kushtet e trajtimit ambulator në banesë, duke kufizuar në mënyrë drastike numrin e qytetarëve të diagnostikuar me Covid 19 që përftojmë efektivisht barna të rimbueshme në kuadër të trajtimit ambulator, krahasuar me numrin e atyre që kanë nevojë reale e që do të duhej të përfitonin rimbursim, duke eliminuar kështu mundësinë e marrjes në konsideratë të analizës së tamponit të kryer në institucionet shëndetësore private.

Gjithashtu në informacionin e marrë zyrtarisht nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidhur me numrin e pacientëve përfitues për periudhën 19.11.2020 deri në datë 31.01.2021 rezulton të jenë ekzekutuar 2988 receta me rimbursim. Ndërkohë që numri real i personave të prekur me Covid 19 dhe bërë publik çdo ditë nga MSHMS: për periudhën 19 Nëntor 2020 deri në 31 Janar 2021 është 47 982 persona, pra mesatarisht 648 të prekur në ditë<sup>1</sup>. Ndërsa ky numër deri në dt.10.03.2021, është **85 406** persona<sup>2</sup>. Pra nga sa rezulton konstatojmë se numri i përfituesve është jashtëzakonisht i vogël në raport me numrin e të infektuarve. Kjo evidencë statistikore duhet t'ju angazhojë ju si MSHMS, për të ndërmarrë fushata sensibilizuese në rang kombëtar nëpërmjet mediave audiovizive, rrjeteve sociale si dhe mekanizmave të tjera të brendshme të vetë sistemit, që pacientët e infektuar por edhe qytetarët e tjerë të informohen mbi përfitimet e rimbursimeve të ilaçeve dhe mënyrën e marrjes së tyre nga mjeku i familjes. Në gjykimin tonë ky mekanizëm deri më sot rezulton në këto shifra përfitimi si inefektiv për kategorinë përfituese të qytetarëve.

Sjellim në vëmendje se Shqipëria renditet vendi i fundit në rajon për kryerjen e tesimeve për million banorë, në raport me vendet fqinje si Kosova, Maqedonia, Kroacia, Mali Zi etj.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> Coronanavirus.al/statistika

<sup>2</sup> Coronanavirus.al/statistika

<sup>3</sup> Burimi: <https://www.worldometers.info/coronavirus/>

Sa më sipër parashtriam në lidhje me kategoritë jo përfituese, rezulton të jetë në kundërshtim të hapur me parashikimet dhe detyrimet ligjore të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 15/2016 “Për Parandalimin dhe luftimin edhe sëmundjeve infektive” dhe në Ligjin nr.10138/2009 “Për Shëndetin Publik”, ky vendim i Këshillit të Ministrave duke mbajtur e përforcuar një qëndrim diskriminues ndaj aksesit të barabartë që duhet të kenë qytetarët për kujdes shëndetësor (diagnostikues e trajtues) të ofruar nga shteti.

Sjellim në vëmendje se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton se “...**shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti...**”. Me tëj, neni 4 i Ligji Nr.15/2016 “Për Parandalimin dhe luftimin edhe sëmundjeve infektive”, parashikon se “.... **parandalimi dhe luftimi i infeksioneve dhe sëmundjeve infektive ofrohet pa asnjë lloj diskriminimi... çdo person ka të drejtë të përfitojë nga masat për mbrojtjen nga sëmundjet infektive... çdo person i sëmurë nga sëmundjet infektive me karakter epidemik ka të drejtën dhe detyrimin të mjekohet falas në çdo institucion shëndetësor publik apo jopublik.** Në vijim Ligji nr.10138, dt.11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, parasheh se “.....**parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve infektive përfshin mbikëqyrjen epidemiologjike, si dhe tërësinë e masave, që synojnë parandalimin e zhvillimit të agjentëve infektivë, minimizimin e shfaqjes ndaj infeksioneve, reduktimin e ndjeshmërisë së individëve dhe të popullatës ndaj sëmundjeve infektive, parandalimin e zhvillimit të shenjave biologjike e klinike të këtyre sëmundjeve, **diagnozën e hershme dhe trajtimin e bazuar në evidencë të sëmundjeve infektive...**”**

Me referencë skemat (protokollet) e rimbushueshme të trajtimit me barna të individëve të infektuar me Covid -19, VKM-ja nr. 908, dt.18.11.2020 “Për miratimin e paketës së barnave për trajtimin ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me Covid-19”, vendosi rimbursimin e dy paketave për trajtimin ambulator, përkatësisht për stadin I dhe II. Për stadin I u miratua rimbursim deri në vlerën 1,650 lekë, ndërsa për Stadin II u miratua rimbursim deri në vlerën 10,900 lekë.

Vlerësojmë, se këto vlera nuk reflektojnë kostot reale të trajtimit ambulator, pasi nuk marrin në konsideratë rimbursimin e analizave të tjera laboratorike dhe ekzaminimet imazherike **për diagnostikimin dhe monitorim të ecurisë klinike të pacientit**, të cilat megjithëse “*de jure*” nuk janë pjesë e skemave/protokollit të trajtimit të Covid 19, “*de facto*” kryhen në menyrë rutinore në kuadër diagnostikimit dhe monitorimit të domosdoshëm të ecurisë së sëmundjes.

OBSH-ja në rekomandimet e saj, sistematikisht referon tek diagnostikimi kliniko-imazherik për rastet me Covid-19, pra diganostikimin edhe përmes egzaminimit imazherik (CT Skaner), me qëllim rritjen e aksesit të pacientëve për marrjen e barnave me rimbursim<sup>4</sup>.

Shqipëria dhe 192 shtete të tjera anëtare të Kombeve të Bashkuara në shtator 2015, miratuan Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Axhenda e vitit 2030 është një kornizë globale 15-vjeçare e përqendruar në 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Axhenda e vitit 2030 synon një botë pa varfëri dhe uri, me arsim cilësor, mbulim shëndetësor universal, arritje të barazisë gjinore dhe fuqizim të grave dhe vajzave, dhe me një mjedis të qëndrueshëm. Objektivi 3

<sup>4</sup> <https://www.who.int/>

“Sigurimi i jetës së shëndetëshme dhe promovimi i mirëqënies për të gjithë në të gjitha moshat”, i Axfordës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, përcakton detyrimin e shtetit për mbulimi shëndetësor universal, përfshirë mbrojtjen nga rreziku financiar të qytetarëve, qasjen e tyre në shërbime cilësore thelbësore të kujdesit shëndetësor dhe në barna dhe vaksina të sigurta, efektive, cilësore dhe të përballueshme për të gjithë.

Kuadri ligjor egzistues për përballimin e situatave epidemike, dhe më konkretisht Ligjit Nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, përcakton qartas detyrimin që ka shteti që të përballojë çdo shpenzim të qytetarëve në lidhje me trajtimin dhe konkretisht neni 4, gërma e) specifikon se: *“çdo person i sëmurë nga sëmundjet infektive me karakter epidemik ka të drejtën dhe detyrimin të mjekohet falas në çdo institucion shëndetësor publik apo jopublik”*.

Duke pohuar se skemat e trajtimit me barna të rimbursueshme të pacientëve me Covid-19 kanë qenë një sfidë e sistemeve shëndetësore qysh në fazën e hershme të identifikimit të pandemisë, duke referuar se ankesat e shumta të regjistruara për trajtim prej muajsh në institucionin e Avokatit të Popullit (ku si problematikë përfaqësuese indentifikohet pamundësia e përballimit të kostove të trajtimit mjekësor), si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat dhe raportimet e organizatave të shoqërisë civile që operojnë në fushën e të drejtave të pacientëve, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të angazhohet për marrjen e masave të menjëherëshme e të domosdoshme për të mundësuar ushtrimin efektiv të së drejtës së qytetarëve për kujdes shëndetësor dhe akses të barabartë në shërbimet shëndetësore diagnostikuese e trajtuese, të ofruar nga shteti, në kuadër të pandemisë Covid-19.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

### **REKOMANDON:**

- ***Zgjerimin e paketës së barnave për trajtimin ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me COVID-19, duke përfshirë në të analizat laboratorike dhe ekzaminimet imazherike për diagnostikim dhe monitorim të ecurisë klinike të pacientit;***
- ***Garantimin e ofrimit pa asnjë diskriminim të shërbimit shëndetësor, duke përfshirë si kategori përfituese edhe individët të diagnostikuar me Covid -19, për periudhën Mars-Nëntor 2020.***
- ***Garantimin e ofrimit pa asnjë diskriminim të shërbimit shëndetësor – pakete barnash, duke mos e kufizuar atë vetëm për pacientët e konfirmuar pozitiv me tampon nga institucionet shëndetësore publike por duke e ofruar atë për të tërë pacientët e diagnostikuar me këtë***

***sëmundje infektive pavarësisht mënyrës së kryerjes së ekzaminimit apo institucionit shëndetësor kur është kryer ai.***

- ***Gjetjen e mekanizmave përkatës për të mundësuar rimbursimin e këtyre shpenzimeve.***
- ***Marrjen e masave për gjetjen e instrumentave për ndërrmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese për qytetarët përfitues të rimbursimit nga shteti të paketës së ilaçeve të Covid 19.***

*Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merren për zbatimin e tij, lutem të na vini në dijeni brenda afateve më të mira.*

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**ERINDA BALLANCA**